



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1124 / Prot.

Patos, më 23/05 / 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 21 MAJ 2025

Vendi: Njësia Administrative Ruzhdie

Ora e fillimit: 10:00

Ora e mbarimit: 11:00

Dëgjesë publike me temë: Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave Buxhetore për vitin 2026"

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Rregullores së Këshillit Bashkiak "Për konsultimin publik", si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 "Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026".

Pjesëmarrës: Kryetar i bashkisë z. Fation Duro, Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, GMS e bashkisë Patos, përfaqësues nga bashkia Patos, administratorë i njësisë Ruzhdie z. Agim Mesutaj, *rreth 27 pjesëmarrës (kryetarë të fshatrave dhe përfaqësues të banorëve të njësisë Zharrëz).*

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetar i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjesë publike me temë:

**Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e
kërkesave Buxhetore për vitin 2026"**

Maj 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”, sot do të zhvillojmë këtë dëgjese publike për të rishqyrtuar edhe njëher kërkesat buxhetore që ju keni ndaj bashkisë Patos.

Kryetar i bashkië Patos, z. Fation Duro— përshëndetje të gjithëve! Faleminderit që keni ardhur sot në këtë takim. Herën e fundit ju keni paraqitur disa kërkesa lidhur me investimet



**Kryetar i bashkië Patos
z. Fation Duro**

**Rishqyrtimin e kërkesave prioritare
për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave Buxhetore për
vitin 2026”**

Maj 2025

në pjesën e infrastrukturës së rrugëve bujqësore, parcelat, investim në shtrimin e rrjetit të ndriçimit rrugor, të ndërhyet nga bashkia për procedurën e certifikimit të pronës, ofrimi i shërbimit të ujësjellsit. Për sa i përket investimeve në pjesën e infrastrukturës rrugore për momentin ne kemi filluar nga rruga Ymeraj në Gjynoqarë dhe do të vazhdojmë edhe në Siqecë me rrugën Xhepaj, rrugën Malaj, Hysaj dhe Xhoraj. Lidhur me parcelat bujqësore ne kemi përfunduar me Kasnicën dhe këto ditë do kaloj mjeti edhe këtu në njësi dhe do përfundoj ndërhyrjet në këtë zonë. Edhe rrugët që janë ekzistuese nëse do të duhet ndonjë ndërhyrje për pastrim ose diçka tjetër do të ndërhyet. Me marrjen e çakullit kemi parashikuar disa rrugë me çakull këtu dhe për sa i përket ndriçimit rrugor te ndërhyrjet në Siqec kemi ndriçim që u bë, gjithashtu në Mashkullor, Veliqaj, Mekami dhe në total kemi vendosur diku te 130-140 ndriçues. Unë do të shikoj edhe ndonjë mundësi tjetër që edhe këtë vit të kemi ndonjë ndërhyrje tjetër. Padyshim që rrugët që do të shtrohen që janë rrugët Myftaraj dhe Veliqaj. Një rrugë tjetër që do përpiqemi ta mbyllim është edhe rruga që shkon të Manxharaj. Rruga Ymeraj gjithashtu do përfshij edhe ndriçimin pasi të përfundoj shtrimi i saj. Për ujësjellsin duhet theksuar që tashmë është në fazën e fundit dhe do bëhet shpërdarja e linjave në banesa. Për Drenien duhet të shikojmë se në çfarë faze e kanë projektin e ujësjellsit dhe deri ku do shtrihet.

Administrator i njësisë Ruzhdie, z. Agim Mesutaj- Te Mashkullorët janë diku te 20 familje



**Administrator i njësisë Ruzhdie
z. Agim Mesutaj**

Dëgjesë publike me temë:

**Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja
e kërkesave Buxhetore për vitin 2026”**

Maj 2025

që nuk janë përfshirë në projektin e ujësjellsit. Distanca më e largët mund të jetë 50 m.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro– Ky është një problem që do të zgjidhet nga



**Kryetar i fshatit Rusinj
z. Ajet Bregu**

Dëgjesë publike me temë:

**Rishqyrtimin e kërkesave prioritare
për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave Buxhetore për
vitin 2026”**

Maj 2025

ujësjellsi sepse është një distancë e zgjidhshme. Do të shikojmë edhe në Drenie për të bërë pjesën e lidhjes me Luarën. Këto kemi të parashikuara, janë dy rrugë në Ruzhdie, Gjy노qarë është rruga Ymeraj dhe po vlerësojmë edhe rrugën Manxharaj. Ngelen në Siqecë tre segmente rrugor dhe Kasnica që ka ngelur vetëm për asfaltimin që do filloj shumë shpejt.

Banor i fshatit Gjy노qarë, z. Etem Manxharaj – përshëndetje! Unë ju falenderoj kryetar



**Kryetar i fshatit Dukas
z. Ilmi Myftari**

Dëgjesë publike me temë:

**Rishqyrtimin e kërkesave prioritare
për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave Buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

për këto punë. Unë banoj në Gjynoqarë dhe kam edhe një fabrikë vaji aty. Aty në atë zonë nuk kam parë ndonjë kujdes ose ndërhyrje le të themi. Rruga nga fabrika Manxharaj deri te zona e Ballshit është shumë problematike dhe nuk kalon asnjë lloj mjeti.

Kjo rrugë është e rëndësishme pasi kalon i gjithë fshati. Rrugët e arave në Gjynoqarë kanë shumë probleme dhe traktori nuk ka ardhur ende.

Kryetar i bashkisë Patos, z. Fation Duro- Besoj që traktori do të vij javës tjetër për ndërhyrje. Kjo pasi ka pasur disa pengesa gjatë punës dhe disa probleme të vogla me defektin që kishte dhe me karburantin. Nuk e mendoja që do të kishte kaq shumë nevojë për rrugë parcelash në çdo vend dhe patjetër që do të ndërhyet në të gjitha rrugët e parcelave ku ka nevojë. Besoj që nuk do të ngelet më asnjë rrugë parcele në Ruzhdie pa hapur.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjesë publike me temë:

**Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave Buxhetore për vitin
2026”**

Maj 2025

Administrator i njësisë Ruzhdie, z. Agim Mesutaj– Unë të falenderoj Kryetar për çdo punë që bën dhe që do vazhdosh të bësh për njësinë Ruzhdie. Problemet nuk mbarohen dhe çdo



**Banor i fshatit Rerës
z. Bashkim Isufaj**

Dëgjesë publike me temë:

**Rishqyrtimin e kërkesave prioritare
për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave Buxhetore për
vitin 2026”**

Maj 2025

banori unë i kam mbajtur shënim problemet në mënyrë që ne ti japim një zgjidhje. Gjynoqara vërtet ka nevojë për investim dhe ashtu siç janë bërë edhe ndërhyrjet në Ymeraj dhe po vazhdojnë dhe në Manxharaj që po premtohet dhe pjesën e Greçies ne do ta bëjmë me rërë bituminoze, kemi shpresa që do ndërhyjmë sa më shpejt. Pjesa e arave në Gjynoqarë nuk ka shumë volum me pjesën e pastrimit dhe patjetër që do ndërhyet. Te pjesa e bllokut kam një

merak sepse është thika 4 m dhe mos kemi probleme te ulla e banorëve, por do ta rregullojmë. Për pjesën e Drenies nëse do të mund të përdorim përsëri rrëzë bituminoze do të ishte shumë mirë. Në qoftë se ne kemi harruar ndonjë rrugë bujqësore në terren le të na thonë që ta vendosim në listë. Te Ruzhdia më shumë do ndërhyrje në katër rrugët e lagjes, ka nevojë për ndërhyrje te Kocomili, Mekami, Memaj, Veliaj që janë 4 rrugët e lagjeve.

Banor i fshatit Gjynqarë, z. Etem Manxharaj- në Gjynqarë janë shumë familje që kanë nevojë për ndërhyrje në rrugët aty. Kjo është shumë emergjente për ndërhyrje. Nuk kanë ku të kalojnë njerëzit, janë shumë familje. Ne jemi shumë bashkëpunues, edhe për pjesën e taksave do të jemi të rregullt.



**Kryetar i bashkisë Patos
z. Fation Duro**

Dëgjese publike me temë:

**Rishqyrtimin e kërkesave prioritare
për hartimin e PBA-së 2026-2028
dhe marrja e kërkesave Buxhetore
për vitin 2026"**

Maj 2025

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- Nëse nuk keni më kërkesa apo sugjerime e konsiderojmë të mbyllur këtë dëgjese publike. Faleminderit për pjesëmarrjen dhe kërkesat tuaja! Do të dëgjohemi në takime të tjera.



**Kryetari i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjese publike me temë:

**Rishqyrtimin e kërkesave prioritare
për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
marrja e kërkesave Buxhetore për vitin
2026"**

Maj 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba

Foto nga dëgjesa publike më temë: “Rishqyrtimin e kërkesave prioritare për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe marrja e kërkesave Buxhetore për vitin 2026”

21 Maj 2025

